

Në bazë të nenit 24-b paragrafit (20) të Ligjit për Arsimin e Mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe 64/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 229/20 dhe 78/25), Ministria e Arsimit dhe Shkencës solli

RREGULLORE

PËR MËNYRËN E NDARJES SË SHPËRBLIMIT TË NJËHERSHËM TË XËNËSVE TË TALENTUAR DHE ME DHUNTI NGA ARSIMI FILLOR, I CILI KA MARRË PJESË NË OLIMPIADË APO GARË NDËRKOMBËTARE TË ORGANIZUAR PËR NXËNËS TË ARSIMIT TË MESËM DHE KA FITUAR ÇMIMIN E PARË, TË DYTË OSE TË TRETË OSE MEDALJE TË ARTË, TË ARGJENDTË OSE TË BRONZTË NË OLIMPIADË APO GARË NDËRKOMBËTARE, SI DHE KA MARRË PJESË DHE FITOI VENDIN E PARË NË GARË NË NIVEL SHTETËROR PËR NXËNËS TË ARSIMIT TË MESËM

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e ndarjes së shpërblimit të njëhershëm të nxënësve të talentuar dhe me dhunti të shkollës fillore, i cili ka marrë pjesë në olimpiadë ose garë ndërkombëtare të organizuar për nxënës të arsimit të mesëm dhe fitoi çmimin e parë, të dytë ose të tretë ose medalje të artë, argjendtë ose bronz të në olimpiada ose garë ndërkombëtare, si dhe morri pjesë dhe fitoi vendin e parë në garë ndërkombëtare për nxënës të arsimit të mesme.

Neni 2

Me olimpiadë ndërkombëtare ose garë ndërkombëtare nga neni 1 i kësaj rregulloreje, nënkupton olimpiadë, gjegjësisht konkurs në të cilin marrin pjesë nxënës prej të paktën dhjetë vende të ndryshme, në të cilin krahasohen njohuritë ndërmjet nxënësve nga vende të ndryshme dhe renditen nxënësit më të mirë nga të gjitha vendet pjesëmarrëse.

Neni 3

Shpërblimi i njëhershëm ndahet në lartësinë e pagës mesatare neto të paguar për punonjës në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin paraprak para ndarjes së shpërblimit në të holla. Për garat ndërkombëtare të cilat realizohen në mënyrë elektronike në distancë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: Ministria) nuk ndan shpërblim në të holla nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 4

Të drejtën e shpërblimit të njëhershëm nga neni 3, paragrafi 1 i kësaj rregulloreje, e ka nxënësi i talentuar dhe nxënësi me dhunti të arsimit fillore i cili ka marrë pjesë në olimpiadë ose garë ndërkombëtare të organizuar për nxënës të shkollave të mesme dhe fitoi çmimin e

parë, të dytë ose të tretë ose medalje të artë, të argjendtë ose të bronzit në olimpiada ose gara ndërkombëtare, si dhe morri pjesë dhe fitoi vendin e parë në garë në nivel kombëtar për nxënës të shkollave të mesme.

Neni 5

Për ndarjen e shpërblimittë njëhershëm nga neni 3, paragrafit 1 i kësaj Rregullore, Ministria publikon thirrje publike, e cila do të zgjasë deri më 31 dhjetor të vitit vijues në të cilin organizohet konkursi.

Në thirrje përcaktohen edhe dokumentet e nevojshme për aplikim në thirrje.

Neni 6

Thirrja nga neni 5 i kësaj Rregulloreje do të publikohet në faqen e internetit të Ministrisë.

Nxënësi i cili aplikon në thirrjen duhet të plotësojë fletëparaqitje elektronike në portalin <http://e-uslugi.mon.gov.mk> me të cilën duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme të shënuara në nenin 7 të kësaj Rregulloreje.

Neni 7

Dokumentet e nevojshme të cilat dorëzohen me fletëparaqitjen, sipas nenit 6, paragrafit 2 të kësaj Rregullore janë:

- vërtetim se nxënësi është nxënës i rregullt në shkollën fillore;
- diplomë për vendin e parë, të dytë ose të tretë të fituar në olimpiadë apo garë ndërkombëtare të organizuar për nxënës të arsimit të mesëm, ose medalje të artë, të argjendtë apo të bronzit të fituar në olimpiadë apo garë ndërkombëtare të organizuar për nxënës të arsimit të mesëm, si dhe për vendin e parë të fituar në garë në nivel shtetëror për nxënës të arsimit të mesëm;
- kopje të llogarisë rrjedhëse në emër të nxënësit;
- deklaratë për pëlqim për përpunimin e të dhënave personale, e nënshkruar me emër dhe mbiemër të plotë nga prindi, përkatësisht kujdestari i nxënësit.

Neni 8

Fletëparaqitja nga neni 6 dhe dokumentet nga neni 7 i kësaj Rregullore i shqyrton komisioni i formuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshëm: ministri), i cili përbëhet nga pesë anëtarë, prej të cilëve tre janë përfaqësues nga radhët e të punësuarve në Ministri dhe dy përfaqësues nga radhët e të punësuarve në Byron për Zhvillimin e Arsimit. Njëri nga anëtarët e komisionit është kryetar, i cili emërohet nga ministri..

Komisioni nga paragrafi 1 i këtij neni shqyrton fletëparaqitjen dhe dokumentet në afat prej 30 ditëve nga dita e aplikimit elektronik.

Komisioni do të përgatisë raport me propozim listë të nxënësve të cilëve do t'u ndahet shpërblimi i njehershëm, i përcaktuar në nenin 3, paragrafin 1 të kësaj rregulloreje.

Ministri, mbi bazë të raportit nga paragrafi 3 i këtij neni, sjell aktvendim për pagesën e shpërblimit të njehershëm për nxënësin, përkatësisht aktvendim për refuzimin e kërkesës për pagesën e shpërblimit të njehershëm për nxënësin, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të raportit sipas paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 9

Shpërblimi i njehershëm për nxënësin paguhet në llogarinë rrjedhëse të nxënësit, në afat prej 30 ditëve nga dita e sjelljes së aktvendimit për pagesë, sipas nenit 8, paragrafit 4 të kësaj rregulloreje.

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme pas sjelljes së tij.

Nr. . 18-9669/1

07.07. 2025

Министерка за образование и наука,
Ministre e Arsimit dhe Shkencës,
проф. д-р Весна Јаневска